



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.608/8 prot

Datë 24.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 414/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TREG AUTO” SHANë procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SH.A, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRONIX” SH.A, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SI & CO COMPANY” SH.P.K, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA – OIL” Sh.A, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga 2 operatori ekonomik “EXIMOIL” SH.A, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “AUTO MANOKU” SH.A, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TREG AUTO” Sh.A në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “TREG AUTO” SHAME NIPT K01418014P dhe adresë Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Llazar Xhajanka, Godina ne Z.Kadastrale nr.8230, Nr.Pasurie 7/56.

“TOP-OIL” SHA, me NIPT (K16604717F), me adresë: PESHKOPI, Dibër.

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “TREG AUTO” SHAME NIPT K01418014P dhe adresë Njesia Bashkiake nr.6, Rruga Llazar Xhajanka, Godina ne Z.Kadastrale nr.8230, Nr.Pasurie 7/56.

“ELBA-OIL 2015” SH.A me NIPT L52606201T dhe adresë Xibrake Labinot fushe, Kantjeri midis fshatrave Mirake-Xibrake, Elbasan.

“TRONIX” SH.A me NIPT L71821024L dhe adresë Vaqarr, Zona Kadestrale 3712; Tiranë.

“SI & CO COMPANY” SH.P.K me NIPT L21420002F dhe adresë Rruga Qemal Stafa, ndertesa nr.pasurie 3/252- N7, ZK.8140, dyqani D-07, Tirane.

“KAPPA – OIL” Sh.A me NIPT J91402501L dhe adresë Xhafzotaj, XHAFZOTAJ, Zona Kadastrale 2547, Durres.

“EXIMOIL” Sh.A me NIPT K91715006E dhe adresë Kashar, Yrshek Njesia Administrative Kashar, Lagjia Yrshek, Rruga "7 Nentori", Tirane.

“AUTO MANOKU” SH.P.K me NIPT K92128001N dhe adresë Njesia Bashkiake nr-7, Rruga e Kavajes, Pallati-152, Hyrja-1, Tirane.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomik ankimes kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.5. Ankimesit kanë plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19-01-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 05.02.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 17-02-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “KADIU” SHA,	me vlerë 3,390,687	lekë skualifikuar
2. OE “TREG AUTO” SH.A,	me vlerë 3,818,641.67	lekë skualifikuar
3. OE “KAPPA - OIL” Sh.A	me vlerë 3,963,110	lekë kualifikuar
4. OE “ELBA-OIL 2015” Sh.A	me vlerë 4,102,050	lekë kualifikuar
5. OE “TRONIX” Sh.A	me vlerë 4,269,500	lekë kualifikuar
6. OE “EXIMOIL” Sh.A	me vlerë 4,518,447	lekë kualifikuar
7. OE “SI & CO COMPAN” Sh.A	me vlerë 4,518,447	lekë kualifikuar
8. OE “AUTO MANOKU” Sh.A	me vlerë 4,606,227	lekë kualifikuar
9. OE “TOP-OIL” Sh.A	me vlerë 4,606,230	lekë kualifikuar
10. OE “ERVIN LUZI” P.F	me vlerë 6,092,300	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 25.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 26.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa

me numër ankimi elektronik A/2026/6365 dhe me nr. 608/2026 prot., datë 26.02.2026 e operatorit ekonomik “TREG AUTO” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 608/1 prot., datë 26.02.2026. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TREG AUTO” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.155/8 prot., datë 04.03.2026, protokolluar me tonën me nr.608/2 prot., datë 05.03.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin në lidhje me ankesën e OE “TREG AUTO” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e OE “TREG AUTO” SHPK, ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e ankesës. Gjithashtu shkresa me nr.155/9 datë 05.03.2026 është përcjellë nëpërmjet postes nga autortiteti kontraktor dhe protokolluar me tonën me nr.608/3, datë 09.03.2026 në përmjetje të së cilës rezulton trajtimi i ankesës së OE “TREG AUTO” SHPK, ankimues ku në përfundim është vendosur refuzimin i ankesës.

II.8. Me shkresën nr. 608/4 prot., datë 12.03.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie informacioni KPP-së lidhur me dokumentacionin shoqërues dhe vërtetimet përkatëse të paraqitura nga operatori ekonomik “TREG AUTO” SHPK qëllim vijimin e trajtimit të ankesës së këtij të fundit.

II.9. Me shkresën nr. 155/13 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 608/5 prot., datë 18.03.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacionit origjinal / kopjet e noterizuar të tyre, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Treg Auto” Shpk., për përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor të parashikuara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.10. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6385, datë 03.03.2026 dhe me nr. protokolli 687/2026 datë 03.03.2026 e operatorit ekonomik “TOP-OIL” SHA për procedurën e prokurimit t “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 687/1 prot., datë

04.03.2026. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatorët ekonomik “KAPPA – OIL” Sh.A; “ELBA-OIL 2015” SH.A; “TRONIX” SH.A, “EXIMOIL” SH.A; “SI & CO COMPANY” SH.P.K; “AUTO MANOKU” SH.A, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “TREG AUTO” Sh.A.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr.155/10 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr.687/2 prot., datë 10.03.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin në lidhje me ankesën e OE “TOP OIL” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e OE OE “TOP OIL” SHPK ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e ankesës. Gjithashtu shkresa me nr.155/11 datë 10.03.2026 është përcjellë nëpërmjet postes nga autortiteti kontraktor dhe protokolluar me tonën me nr.687/3, datë 11.03.2026 në përmjetje të së cilës rezulton trajtimi i ankesës së OE “TOP OIL” SHPK ankimues ku në përfundim është vendosur refuzimin i ankesës.

II.13. Referuar parashikimeve të nenit 113 të “Ligjit për prokurimin publik”i ndryshuar, rezulton se nuk ka argumenta nga palët e interesuara, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, që kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur ankesën nr. A/2026/6365 dhe me nr. 608/2026 prot., datë 26.02.2026 e ankimuesit “TREG AUTO” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyen se: *“Me dt.13.02.2026 kemi sjelle prane jush, Rruga Reshit Collaku , Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) dosjen/zarfin me dokumentat e vertetimet e mundshme fizike. Keto dite e-albania, sikunder dihet, ka patur probleme teknike per aksesim dhe shkarkim dokumentacioni nga operatorët. Nga dokumentat e shtojces 9-Formulari i vetedeklarimit, kemi sjelle te gjithë ato dokumenta qe kemi mundur te shkarkojme brenda dy diteve pune. Theksojme se TREG AUTO Sh.A. eshte kompani serioze dhe i ka shlyer gjithnje ne kohe te gjitha detyrimet me shtetin (tatimet, Sig Shoqerore Shendetesore, Vendore etj). Per informacionet e munguara saktesojme se autoriteti kontraktor eshte shprehur tek shtojca 9-Formulari i vetedeklarimit (tek faqja e parafundit e formularit) si vijon: Informacioni i pasqyruar në formularin e vetedeklarimit, i cili gjendet*

në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund te aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash...

-vërtetim për shlyerjen e taksave vendore (lutem verifikoni se ky dokument është dorëzuar fizikisht bashkë me dosjen me dt.13.02.2026)” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, pjesa II pika A “**DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**” është parashikuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 9.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)  
**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT – i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</b>



<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i>				
<i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</i>				
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>				
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i>				
<i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i>				

<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
_____				
<p><i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>				

## **B: DEKLARATA**

### ***Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura***

*Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:***

*Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.*

*Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>1</sup>.*

*Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:*

- a) çmimet;*
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*

*Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.*

*Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.*

## **C: DEKLARATA**

### ***Mbi Konfliktin e Interesit***

#### ***Deklarata***

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:*

<sup>1</sup> Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

*Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.*

*Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:*

*- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.*

*Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.*

*Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).*

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.***

*Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".*

*Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.*

#### **D: DEKLARATA**

**Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

**Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit****A: DEKLARATË**

**Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti	<u>Punonjës</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [ ] Jo [ ] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>

kontraktor.

Emri, Mbiemri \_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.
- Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

*Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.”*

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.3. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.4. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës...”

III.1.5. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënua për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; 10 h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.7. Për sa i përket arsyes se skualifikimit të operatorit ekonomik, me pretendimin se “*pasi nuk ka paraqitur “vërtetim për shlyerjen e taksave vendore”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se nga verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se në shtojcën 8, janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim, nga ku nuk evidentohet të jetë përcaktuar ndonjë kërkesë për dorëzim “dokument provues që provon likuidimin e detyrimeve tatimore dhe të taksave vendore”, madje në asnjë vend në dokumentat e tenderit nuk janë përcaktuar kërkesa të tilla.

III.1.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë në lidhje me dorëzim “dokument provues që provon likuidimin e detyrimeve tatimore dhe të taksave vendore”, ndaj paraqitja apo mosparaqitja e këtij dokumentacioni nuk mund të përbëjë shkak për kualifikimin/skualifikimin e një operatori ekonomik. Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e

autoritetit kontraktor nuk janë kërkuar përmbushja e kërkesave të tilla lidhur me provueshmërinë e detyrimeve të taksave vendore, rrjedhimisht, autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij, në dokumentat e tenderit. Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i pa paraqitur nga operatori ekonomik “TREG AUTO” SHANë këtë procedurë prokurimi, dokument provues qe provon likuidimin e detyrimeve tatimore dhe te taksave vendore nuk përbën shkak as arsye për skualifikim lidhur me kërkesat e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “TREG AUTO” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyen se: *“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë verifikimit të dokumentacionin të paraqitur konstatoi se: - Operatori ekonomik “Treg Auto” Sh.A, NIPT K01418014P nuk plotëson kriterin e përgjithshme të kualifikimit pika 1, shkronja dh pasi nuk ka paraqitur “vërtetim për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore”, dokument i cili referuar VKM Nr 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar nenit 26, pika 6 është dokument i detyrueshëm të paraqitet nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për vërtetimin e deklaratës së bërë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit seksioni ku thuhet “Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”... Me dt.13.02.2026 kemi sjelle pranë jush, Rruga Reshit Collaku , Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) dosjen/zarfin me dokumentat e vërtetimit e mundshme fizike. Keto dite e-albania, sikunder dihet, ka patur probleme teknike për aksesim dhe shkarkim dokumentacioni nga operatorët. Nga dokumentat e shtojcës 9-Formulari i vetedeklarimit, kemi sjelle te gjithë ato dokumenta qe kemi mundur te shkarkojme brenda dy diteve pune... Referuar sa me lart, lutemi qe: Autoriteti Kontraktor te shfrytëzoje te drejten e permendur ketu me lart dhe te aksesojë direkt ne e-albania dhe te verifikojë direkt informacionin lidhur me : -vërtetim për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore (TREG AUTO)”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, është parashikuar si më poshtë vijon:

*“Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

***Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.***

- *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.*
- *Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.*
- *Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.*
- *Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.”*

III.2.2 Komisioni nga verifikimet e kryera konstaton se operatori ekonomik “TREG AUTO” SH.A ka plotësuar formularin me të dhënat si më poshtë:

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_ kemi paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore \_\_\_\_\_*

**Dokumentacioni është i disponueshem në forme elektronike:**

**Adresa e ueb-it: <https://e-albania.al/>**

**Autoriteti ose organi lëshues: Drejtoria Rajonale e Tatimeve**

**Lloji i dokumentacionit: Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin, Vërtetim për pagim detyrimesh.**

- Nga verifikim i shkresës nr. 155/13 prot., datë 17.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 608/5 prot., datë 18.03.2026 prej nga ku është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacionit origjinal / kopjet e noterizuar të tyre, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Treg Auto” Shpk., për përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor të parashikuara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk është paraqitur dokumenti “Vertetim per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per tatimpaguesin, vertetim per pagim detyrimesh”.

III.2.3. Për sa më sipër, Komisioni pas verifikimeve të formularit të vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Treg Auto” Sh.A rezulton, se ka plotësuar rubrikën për “vërtetim për shlyerjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore” si më sipër. Gjithashtu Komisioni pasi kreu dhe verifikimin e dokumentacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor për operatorin kualifikuar të parin “Treg Auto” Sh.A, konstatoi se nuk është paraqitur dokumenti fizik *“Vertetim per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per tatimpaguesin, vertetim per pagim detyrimesh”* në mënyrë që të identifikohet dhe provohej në formë shkresore se operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka përmbushur kriterin e e kërkuar në shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit. Gjithashtu lidhur me arsyetimin se *”Keto dite e-albania, sikunder dihet, ka patur probleme teknike per aksesim dhe shkarkim dokumentacioni nga operatoret. Nga dokumentat e shtojces 9-Formulari i vetedeklarimit, kemi sjelle te gjithe ato dokumenta qe kemi mundur te shkarkojme brenda dy diteve pune”*, operatori ekonomik nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të faktuar këtë pretendim, theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh dhe gjithashtu operatori ekonomik ka patur të gjithë mundesit për të kërkuar shtyrje të afatit lidhur me dokumentacion e pa aksesueshem prej *problemeve teknike të sistemit* për tu rivendosur në afat në një moment të dytë nga autoriteti kontraktor qoftë kjo nëpërmjet nëpërmjet sistemit elektronik te prokurimit, seksionit të kërkesave ose meazheve ose edhe në rrugë postare për të vërtetuar faktin e pashmangshëm të pretenduar.

Për sa më sipër pretendimi i OE “TREG AUTO” Sh.A nuk qëndron.

III.3. Lidhur ankesën nr. A/2026/6385, datë 03.03.2026 dhe me nr. protokolli 687/2026 datë 03.03.2026 e operatorit ekonomik “TOP-OIL” SHA, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatorët ekonomik “KAPPA – OIL” Sh.A; “ELBA-OIL 2015” SH.A; “TRONIX” SH.A, “EXIMOIL” SH.A; “SI & CO COMPANY” SH.P.K; “AUTO MANOKU” SH.A, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “TREG AUTO” Sh.A, në procedurën e mësipërme të prokurimit me arsyen se: *“Ofertuesit TREG AUTO Sh.A, ELBA-OIL 2015 SH.A, TRONIX SH.A dhe SI & CO COMPANY SH.P.K, nuk kanë paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT-së, nuk ka arritur të plotësojnë saktë, me të gjitha të deklaratimet dhe të dhënat e kërkuara, duke mos pasqyruar në të, të gjitha të dhënat që ky formular parashikon, referuar kërkesave për kualifikim të përcaktura në shtojcën 8 të DT-së. Ofertuesit, TREG AUTO Sh.A, KAPPA - OIL Sh.A, ELBA-OIL 2015 SH.A, TRONIX SH.A, EXIMOIL SH.A, SI & CO COMPANY SH.P.K dhe AUTO MANOKU SH.A, nuk kanë arritur të plotësojnë këkresat e përcaktuara në kriterin për kualifikim sipas pikës 2.3.2 tek seksioni Kapaciteti teknik të shtojcës 8 të DT-së me përmbajtjen: ?2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike për*

artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike , në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. (Nëse katalogu/ broshura/skeda teknike paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe) Në katalogët/broshurat/skedat teknike të dorëzuara si pjesë e ofertës për procedurën objekt i këtij ankimi, nga ofertuesit TREG AUTO Sh.A, KAPPA - OIL Sh.A, ELBA-OIL 2015 SH.A, TRONIX SH.A, EXIMOIL SH.A, SI & CO COMPANY SH.P.K dhe AUTO MANOKU SH.A, nuk gjejnë pasqyrim të gjithë treguesit cilësorë të kërkuar sipas shtojces 6 të specifikimeve teknike per cdo artikull, mungojnë pasqyrimet e të gjithë parametrave teknike të kërkuara nga AK-ja. Gjithashtu ne pretendojmë se, produktet Vajrat Lubrifikante të ofertuara nga ofertuesit TREG AUTO Sh.A, KAPPA - OIL Sh.A, ELBA-OIL 2015 SH.A, TRONIX SH.A, EXIMOIL SH.A, SI & CO COMPANY SH.P.K dhe AUTO MANOKU, referuar Katalogëve/broshurave/skedave teknike të dorëzuara nga këta ofertues, nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK-ja, pra nuk janë në përputhje me specifikimet teknike. Konkretisht, të dhënat teknike të produkteve me të cilat kanë ofertuar, te paraqitura nga këta ofertues, referuar Katalogëve/broshurave/skedave teknike të dorëzuara në SPE, nuk janë brenda diapazonit të vlerave per treguesit cilesore të kërkuara tek shtojca e Specifikimeve teknike, per produktet: Vaj Motorri 15W-40 , Vaj Motorri 20W-50 , Vaj Motorri automjete 5W-40 , Vaj Motorri automjete 5W-30 , Vaj Motorri automjete 10W-40 , Vaj Motorri automjete SAE 30 , Antifrizë motorri -40C”, Komisioni vëren se pretendimet e mësipërme pavarësisht identifikimit të produkteve të cilat përsëri i referohen mbi gjysmes e produkteve të kërkuara nga autoriteti kontaktor nuk janë identifikuar specifikimet konkrete qe këto produkte të ofertuara nga operatorët ekonomik të tjerë nuk përmbushen ndaj gjykohen si pretendime në total.

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.1. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe,

pretendimit/pretendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.3. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim pro-aktiv, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj, Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.3.4. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e OE ankimes “TOP-OIL” SHA nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e OE “TOP-OIL” SHA, për procedurën e në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-73997-01-16-2026, me objekt: “Blerje lubrifikantë dhe filtra për vitin 2026” për nevoja të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Lezhë.”, me fond limit 6,141,636.0 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
  2. Të pranojë pjesërisht ankesën e OE “TREG AUTO” SHA, për procedurën e në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
  3. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “TREG AUTO” SHA sipas konstatimeve të vendimit të mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik.
  4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin e tarifës financiare në buxhet të shtetit, të paguar nga OE “TOP-OIL” SHA.
  6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TREG AUTO” SHA.
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

